



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 31304/24  
Nr. i fq. / Br. sh. -1-  
Data: / Datum: 03.07.2024  
VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

---

**Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Stroc, Bivolak,  
Beçuk, Gllavatin dhe Zhilivodë**

Korrik 2024

## PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2025, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Stroc, që përfshin fshatrat Stroc, Bivolak, Beçuk, Gllavatin dhe Zhilivodë.

**Vendi: Shkolla "Liria" Stroc**

**Ora: 18:00**

**Data: 02.07.2024**

Të pranishëm nga Komuna ishin Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, asamblistët Mentor Hasani, Bekim Zabërgja, Zojë Hajrizi, Behar Duraku, dhe Bastri Duraku, nga Sekretaria e Kuvendit të Komunës.

**Mentor Hasani, kryesues**, hapi mbledhjen me qytetarë, ku tha se në këtë takim do të merren kërkesat e qytetarëve të Këshillit Lokal Stroc për përfshirje në buxhetin e Komunës së Vushtrisë për vitin 2025.

**Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar**, paraqiti para qytetarëve pjesëmarrës në takim buxhetin e Komunës së Vushtrisë për vitin 2025 dhe projektet e parapara për fshatrat e Këshillit Lokal Stroc.

Gjithashtu, qytetarëve të pranishëm në këtë dëgjim ju është shpërnda material informues për buxhetin e vitit 2024.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

**Habib Aliu, banor i fshatit Gllavatin**, tha se shumë projekte janë mbetur pa u përfunduar kanalizimi, ujë, ndriçim, por apeloj të mbyllet gropa në afërsi të shkollës për shkak të kundërmimit të erës së keqe.

**Halit Hyseni, banor i fshatit Gllavatin**, shprehu pakënaqësi për ndriçimin e shtëpive. Mandej kërkoi të shtrohet rruga me zhavor.

**Kadri Aliu, banor i fshatit Gllavatin**, shprehu pakënaqësinë lidhur me shtrimin e rrugëve, kanalizimit por edhe mos rregullimin e shkollës. Pastaj tha se kompania kontraktuese nuk po kryen si duhet kanalizimin dhe ujësjellësin. Pastaj ceku problemin e pronave dhe përkthimin e tyre. Kërkoi që të shtrihet 70 metra kanalizim dhe disa rrugica.

**Behar Duraku, asamblist dhe kryetar i Këshillit Lokal Stroc**, paraqiti kërkesat, ku tha se duhet të rregullohet trotuari nga shkolla në gjatësi 1 km, pastaj renovimi i dyshemesë së shkollës "Liria". Kërkesa tjera me interes të banorëve të 5 fshatrave janë, **Stroc**: Për rrethojën e shkollës "Liria" Stroc, kanalizimi në lagjen Hasani, Aliu, lagja Shabanaj 1 km, Rrugë: Segmenti 7 Dëshmorët, rruga Armend Aliu, Kadri Duraku 60 metra, rruga Bilall Bilalli 65 metra, Nexhmedin Duraku, Sahit Duraku, Xhafer Duraku, Arben Duraku 150 metra, Muharrem Tahiri 50 metra, Mexhid Duraku 150 metra, Përparim Aliu 150 metra, Lan Aliu 100 metra, Ndriçimi në rrugën 7 Dëshmorët nga shkolla, ndriçimi në rrugën Lan Aliu. **Bivolak**: Rrugët: Nazif Klinaku në Bivolak 50 metra, Berishaj Bivolak 60 metra, Imer Saraqi 100 metra me mundësi këtë vit me u krye. Ndriçimi në lagjen Klinaku- Gani Klinaku. **Beçuk** Rrugë: Rexhep Murati 400 metra, Jahir Murat 550 metra, Ndriçimi në rrugën Abdullah Haliti Gllavatin,

vazhdimi ndriçimit në rrugën Nuhi Haliti gjatësi 500 metra, pastaj rrugët Halit Hyseni 120 metra, Agim Hyseni 50 metra, Faik Duraku 50 metra, Raif Duraku 50 metra, Kadri Aliu 150 metra, Feriz Sadiku 150 metra, Idriz Klinaku 150 metra. **Zhilivodë:** rruga Fahri Krasniqi 120 metra, ndriçimi i rrugës pranë Lapidarit të dëshmorit Shaban Krasniqi.

**Feriz Sadiku, banor i fshatit Gllavatin,** kërkoi të bëhen meremetimet e fushës së futbollit dhe 100m kanalizim dhe ujësjellësi, dhe kërkoi të mbyllet gropa afër shkollës.

**Sabri Duraku, banor i fshatit Stroc,** kërkoi rregullimin e ujësjellësit, si dhe rregullimin e ujit për shkollën e Strocit, rregullimin e dyshemesë në shkollën e Strocit, rregullimin e trotuarit në lagjet Duraku, Hajrizi dhe Mustafa me gjatësi 1 km.

**Afrim Mustafa, banor i fshatit Stroc,** pyeti se kur pritet të lëshohen ujësjellësi.

**Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar,** shpjegoi çështjen e ujësjellësit.

**Habib Mustafa, banor i fshatit Stroc,** kërkoi mbylljen e deponisë së mbeturinave, si dhe rregullimin e ujësjellësit. Prioritet tjetër është rregullimin i Lapidarit të Batalionit të parë të Brigadës 142, rrethoja, rrafshimi i sipërfaqes për rreth këtij lapidari si dhe ndriçimi i tij.

Takimi me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Stroc, që përfshin fshatrat Stroc, Bivolak, Beçuk, Gllavatin dhe Zhilivodë, përfundoi në ora 19:05.

Në këtë takim morën pjesë 11 qytetarë.

Procesmbajtës:

Bastri Duraku





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Vushtrrisë  
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2025

Vendi: Stroc

Datë: 02.07.2024

Ora: 18:00

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Nënshkrimi | Vendbanimi |
|-----|------------------|------------|------------|
| 1   | BEKIM DUKAKU     |            | STROFC     |
| 2   | SABRI DUKAKU     |            | STROFC     |
| 3   | Shafiq Raci      |            | GLLOVOTI   |
| 4   | HALIT HYSENI     |            | GLLOVOTI   |
| 5   | HYSHI HASANI     |            | STROC      |
| 6   | Adriatis DUKU    |            | GLLOVOTIN  |
| 7   | ILIRIZ SADIĆ     |            | GLLOVOTIN  |
| 8   | Agim Mustaf      |            | STROVC     |
| 9   | Shafiq Mustaf    |            | —          |
| 10  | Behar DUKAKU     |            | STROC      |
| 11  | LOJË HATIRI      |            | STROC      |
| 12  |                  |            |            |
| 13  |                  |            |            |
| 14  |                  |            |            |
| 15  |                  |            |            |
| 16  |                  |            |            |